

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT
“Imipant prodhim betoni”



Subjekti: “Kalivioti” sh.p.k

Vendndodhja: Sopik, Komuna Livadhja Sarande

Tirane, 2017

PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Prodhim te profileve te aluminit”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*

- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja* ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis*”.

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti “ KALIVIOTI” **sh.p.k** eshte regjistruar prane QKR me numer NIPT-i **J64228811C** me administrator **Z. Vangjel Kalivjoti** me adrese ne Vlore Livadhja 1 km larg qendres se fshatit Livadhja, ne krahun e djathte te rruges per fshatin ”Lefter Talo” qe ka nr. Kadastral 2473 dhe nr.pasurie 20/1.20/2.20/3.20/4 dhe 20/5, godina nr.1, kati i pare..Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore.

Qellimi i projektit

Qellimi i projektit eshte prodhimi betonit dhe shitja e betonit të gatshëm .

Vendndodhja

Subjekti” KALIVIOTI ” shpk do e ushtroje aktivitetin e tij ne Sopik, Komuna Livadhja Sarande.

Fuqia punetore

Në impiantin e betonit te shoqerine Kalivioti sh.p.k. punojne 8 punonjes. Punonjesit jane ne profesionet e teknologut, manovrator, shoferit dhe punetorit te thjeshte. Për të krijuar një ambient pune optimal dhe sa më konfort, shoqeria Kalivioti ka paisur të gjithë punjësit që punojnë në prodhim me uniformë, kapele mbrojtese dhe me mjete mbrojtëse ndaj pluhurit dhe faktoreve të tjerë.

Projekte te tjera qe do ti vijne ne ndihme aktivitetit

Per zhvillimin e aktivitetit nuk do te kete projekte te tjera sepse sistemi rrugor ekziston,dhe objekti ndodhet buze rruges. Per mbarevajtjen e aktivitetit kjo rruge do te mirembahet nga personeli i shoqerise. Eshte lidhur kontrata me rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike. Ne rast mungese energjia elektrike do sigurohet permes nje gjeneratori. Persa i perket sigurimit te ujit do te sigurehet me bot qe ka ne perdorim subjekti.

Pershkrimi i impjantit dhe proceset qe ndodhen ne te

Impjanti i prodhimit te betonit përbëhet nga këto makineri dhe paisje:

1. Nje tanker i inerteve dhe çimentos.
2. Dy bunkerat, sillosat.
3. Transportjere
4. Paisjet e dozimit
5. Paisjet e komandimit automatik

Procesi teknologjik

Përshkrimi i procesit teknologjik të prodhimit te betonit:

Materjali i thyer dhe i fraksionuar depozitohet ne bunkerin e lende se pare, prej ku dozohet ne menyre automatike se bashku me çimenton dhe transportohen per t'u perzjere edhe me uje dhe aditive te ndryshem per prodhimin e betonit ne perputhje me markat e betonit te kerkuara. Procesi i dozimit dhe transportimit shoqërohet më spërkatje me ujë me qellim te evitimit te pluhurave ne mjedisin rrethues. Ky ujë nëpërmjet sistemit të tubacioneve shkon në impjantin e prodhimit të betonit.

Përdorimi i ujit në dozim dhe transport eliminon pluhurat gjatë ketyre proceseve.

Impjanti prodhimit të betonit është një impjant i cili përbëhet nga 2 bunkerat, silosët kryesorë, një tanker, të inerteve dhe të çimentos dhe salla e komandimit.

Inertet së bashku me çimenton, aditivet dhe ujin nëpërmet transportierëve dhe paisjeve të automatizuara, me doza të përcaktuara simbas markave të çimentove sipas kërkesave të konsumatorëve, përzihen duke prodhuar marka të ndryshme betoni simbas kërkesave të tregut.


Impjanti i prodhimit të betonit, pronë të firmës private “Kalivioti” sh.p.k gjendet në truallin pronë e po kësaj firmë dhe ndodhet ne Sopik, Komuna Livadhja Sarande

SKEMA E IMPIANTIT TË PRODHIMIT TE BETONIT

Procesi teknologjik i prodhimit te betonit në këtë impiant është një proces shumë i thjeshtë, ai konsiton në punën e paisjeve për dozim dhe perzjerje.

Këto procese, janë procese të cilët do të vazhdojnë deri sa të përgjigjet tregu si dhe furnizimi nga karierat e gëlqerorëve, por cka është e domosdoshme për tu theksuar është se këto procese nuk do të ndryshojnë, për pasojë dhe ndikimi që do të kenë ato në sipërfaqen e tokës nuk do të ndryshojë.

SKEMA E PROCESIT TEKNOLOGJIK



1.2.1 Procesi i prodhimit dhe karakteristikat e tij:

- tipi dhe sasia e lëndës së parë, energjisë dhe burimeve të tjera të konsumuara;
- mbetjet dhe emërtimet sipas tipit, sasisë, përbërjes dhe fortësisë, duke përfshirë: shkarkimet në ujë; emetimet në ajër; zhurmat; vibracionet; ndricimi; nxehtësia; radiacioni; depozitimet; depozitimet / mbetjet në tokë dhe dhera; të tjera

Procesi i prodhimit në impjant nënkupton prodhimin e betonit nga inertet e gelqerore dhe lumore. Inertet lumore dhe gelqeroret shërbejnë si lëndë e parë dhe si produkt i prodhimit. Lenda e parë, pra inertet me granulometri nga 0.1mm deri 30mm nga stoku i tyre ngarkohen me anë të fadromave në mjetet e transportit me kapacitet 10m^3 , këto mjetet e shkarkojnë këtë material në bunkerin kryesor të inerteve me kapacitet 15m^3 .

Ky bunker ka në fundin e tij ka një ushqyes vibrues. Nga ky ushqyes me transportier materiali shkon në perzjerjen e betonit së bashku me çimenton.

Prodhimi i betonit i cili realizohet në impjantin e betonit realizohet nga përzierja e përbërësve të betonit, konkretisht të inerteve të fraksionuara si rërë dhe granil me çimento, aditive, ujë, perberes të ciletet nuk ndotin mjedisin rrethues.

Konkludojmë që në procesin e prodhimit të betonit nuk ka produkte, që të dalin si mbetje sterile të ngurta, të lengeta apo në forme gazesh e pluhuri, sepse si produkt fitohet beton i markave të ndryshme simbas kërkesave.



Firma private ““Kalivioti”” sh.p.k. e siguron energjinë elektrike nëpërmejt dy rrugëve të pamvarura nga njëra tjetra.

Furnizimi kryesor kryhet nga rrjeti ndersa për të krijuar pamvarsi nga problemet energjitike ajo ka instaluar një motorr me diegie të brëndëshme të cilin e vë në punë simbas nevojës.

Procesi i prodhimit të betonit është proces i cili nuk ka mbetje teknologjike.

Procesi i prodhimit të betonit në impjant nuk shoqërohet me emetime të dëmshëm për mjedisin. Nisur nga energjia që do përdoret (elektrike) për vënijen në punë të mekanizmave e

paisjeve të impjantit, vërejmë që kjo energji është më e pastra dhe për pasojë nuk do të emetoje elementë ndotës për mjedisin. Gjithashtu procesi teknologjik që zhvillohet aty është proces i cili nuk ka të bëjë me ndryshimin kimik të lëndës, por vetëm me ndryshimin fizik e mekanik të saj.

Në këtë proces nuk do të përdoren kimikate apo lëndë të tjera të cilat mund të përbëjnë premisa për të shkarkuar elementë ndotës në mjedis.

I vetmi element që do të përdoret në procesin teknologjik është uji. Uji do të jetë pjesë e procesit teknologjik duke shërbyer jo vetëm për prodhimin e betonit, por njëkohësisht uji do të neutralizojë sasinë e pluhurave që mund të krijohen gjatë procesit teknologjik.

Në këtë proces uji do të perzihet me inertet dhe me çimenton në sasinë e kërkuar për prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do të ketë ujë që të dalë nga procesi teknologjik.

Në prodhimin e betonit, procesi i thjeshtë mekanik përzierës, futen inerte të pastra, çimento e ujë, procesi teknologjik që zhvillohet nuk ka të bëjë me ndryshimin kimik të lëndës, nuk do të përdoren kimikate apo lëndë të tjera të cilat mund të përbëjnë premisa për të shkarkuar elementë ndotës në mjedis.

Përsa i takon emetimit të zhurmave, ato janë zhurma vetëm brenda normave të lejuara.

Emetime të tjera si vibracione, radiacione, ndricim, nxehtësi etj nuk janë të pranishme.

Aktiviteti i prodhimit të betonit ka si emetim, emetimin e gazrave që dalin nga puna e mjeteve levizese si fadromës dhe makinave të transportit. Këto mjete janë të kolauduara dhe për pasojë emetimet e tyre janë brenda normave të lejuara.

Qëllimi i raportit të Vetmonitorimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit të firmës “Kalivioti” është që të identifikojë pasojat e mundshme negative mjedisore që mund të krijohen gjatë shfrytëzimit të këtij vendburimi. Një synim tjetër është të përcaktoje e rekomandoje masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zvillimit të aktivitetit.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Vlora është një [qytet](#) bregdetar në jugperëndim të [Shqipërisë](#). Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas [Durrësit](#), me një popullsi afërsisht 200,000. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në [Detin Adriatik](#) dhe është qendra e [Rrethit të Vlorës](#) dhe të [Qarkun së Vlorës](#).

Kushtet klimatike

Klima e Rajonit është tipike mesdhetare me një dimër të lagësht e të ngrohte dhe me një vere të nxehte e cila arrin deri në 40 grade. Në përgjithësi në rrethin e Vlores, regjimi i presionit të ulet zgjat pak dhe periudha me kohe të mirë është me të gjatë se në pjesët e tjera të vendit. Faktoret që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

- Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimes.
- Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.
- Larmia e formave të relievit dhe drejtimi i përcaktuar mirë i vargmaleve dhe luginave.

Temperaturat mesatare për Vloren ndryshojnë nga 16,1 në 17,7 grade. Në Vlore mungojnë temperaturat e uleta që regjistrohen në zonat e tjera të vendit. Temperaturat më të uleta, si në të gjithë zonën bregdetare të Shqipërisë, regjistrohen gjatë Janarit-Shkurtit.

Sasia mesatare e reshjeve arrin 1200mm/vit, pjesa më e madhe e të cilave në nëntor-dhjetor. Muajt më të thatë janë Korriku, Gushti dhe Shtatori. Deti dhe format e relievit ndikojnë shumë në shpërndarjen e reshjeve në rrethin e Vlores. Luginat e Shushicës, Dukatit, Borshit e Vjosës shërbejnë gjatë gjithë vitit si zona të shkëmbimit klimaterik të zonave të bregdetit me ato në brendësi. Kjo është arsyeja e shirave të bollshme pranë zonave malore në krahasim me zonat e tjera të rrethit. Ndërsa në zonën bregdetare të qytetit sasia mesatare e reshjeve është 1000mm/vit e në Orikum 1314mm/vit, në zonat malore si Llogara e Dukat, reshjet arrijnë përkatesisht 2500 e 2453mm/vit. Numri mesatar i ditëve me lagështi është 105 - 147 ditë në vit. Debora është një dukuri tepër e rrallë në bregdet, ndërsa në zonat malore është një dukuri normale që fillon që në

mentor. Pozicioni gjeografik i rrethit të Vlores ben qe zona te jete nen ndikimin ererave te fuqishme, qe jane te ndryshme per nga forca dhe prania gjate vitit. Erera te zakonshme jane puhite detare, te cilat ndihen me shume gjate bregdetit. Rrethi i Vlores ne pergjithesi dallohet per ererat e forta, kjo per shkak te konfigurimit te relievit dhe gjirit te Vlores.

Gjeologjia

Rajoni i Vlores i takon zonës paleogjeografike jonike, e cila në perëndim kufizohet me zonën e Sazanit dhe në lindje me zonën e Krujës. Një njësi e veçantë, më e re se të parat, është ultësira pranadriatike që mbivendoset mbi të tria zonat e lartpërmendura. Zona jonike gjatë zhvillimit të vet paleogjeografik ka qenë një basen detar i thelle nga jorasiku në paleogjen, kurse dy zonat fqinje, Sazani dhe Kruja, kanë qenë basene detare të cekëtta, shpesh të dala dhe mbi ujë.

Në fillim të miocenit të mesëm, rreth 15 milion vjet më parë, zona jonike u përfshi nga proceset e rrudhosjes dhe të malformimit, duke u shndërruar dalëngadalë në stere. Në këtë kohë u formuan disa breza të rrudhosur mbiujorë me pamje antiklinale, si brezi antiklinal i Çikës, ai i Kurveleshit, etj.

Midis tyre mbeten breza nënujore në trajtë sinklinale, si ai i Shushicës, ku vendoset edhe Kuçi, Memaliajt etj. Në fund të miocenit, rreth 5 milion vjet më parë, ndodhi një rrudhosje tepër e fuqishme, që e shndërroi ultësirën pranëadriatike në strere me mjaft rrudha antiklinale e sinkinale.

Flora dhe fauna

Mbulesa bimore e rajonit është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjtë dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga : sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja, sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapi. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore.

- **Kafshe e egra**

Nga kafshët e egra më shumë gjendet derri i egër dhe lepuri, të dëmtuar rëndë nga gjuetia. Haset edhe dhelpra, kunadhja, dreri (sorkadhja) gjendet ne pyllin e mbrekullueshem te Zarelit si dhe ne pjesen e poshtme te fshatit si ne Shen Thanas, Perroi i Thate etj, shqarhi (macja e eger), lunderza (vidhra) ne lumin Shushice. Nga shpendët përhapje), kukumjaçka (bufi), qyqja, si dhe harabeli, gushkuqi dhe lloje të ndryshme shpendësh. Ne lumin e Shushicës gjenden me shumice trofta, ndërsa ne përrenjtë qe derdhen ne lume ka shume krap te madhësive te vogla, si dhe ngjala. Ne terrenin me shkurre ka zvarranike te përmasave dhe llojeve te ndryshme, te pastuduara ende. Ka gjarpërinj me madhësi edhe mbi 2 merta, ndodhen gjithashtu edhe nepërka nje gjarpër i rrezikshëm sulmues, astriti dhe gjarpërinj me ngjyra e madhësi te ndryshme. Ne te gjitha pyjet me shkurre te bie ne sy një numër i madh breshkash.

Rrjeti hidrike dhe ujerat

Uji eshte nje pasuri natyrore me vlera te medha kombetare. Ai ka perdorim te madh ne bujqesi, ne industri dhe per furnizimin e qendrave te banuara. Rajoni i Vlores eshte nje rajon bregdetar i cili laget nga deti Adriatik edhe ai Jon, Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe [kufiri](#) ndarës natyror midis rrethit të [Fierit](#) (në veri) dhe rrethit të [Vlorës](#). Ai është një lumi i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Por rajoni eshte i pasur edhe me burime ujore , zona e Kuçit ka pasuri të shumta ujërash, si pak fshatra të Kurveleshit ku numërohen rreth 157 burime ujore. Pasuritë më të mëdha janë burimet e Lëpushës me 550 l/s, dhe buronjat e Kuçe me 300 l/s ; një nga burimet më të mëdha karstike të Shqipërisë jugore. Buronjat e Kuçe shkarkojnë ujërat nëntokësore që grumbullohen në masivin karstik të Kurveleshit të Sipërm, i cili gjendet rreth 600 m më lartë se vendi ku dalin Buronjat. Buronjat përfaqësojnë një objekt me rëndësi turistike për gjithë rajonin.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

Ndikimet në toke

Ndikimet fizike të projektit, si psh ndryshimi në topografine lokale, erozioni i tokës, etj.

Nisur nga teknologjia që përdoret në impjant për prodhim betoni vërejmë se me zbatimin e projektit nuk do të kemi ndikime fizike të projektit, sic mund të jenë ndryshime në topografinë lokale, erozionin e tokës apo ndryshime të tjera të dukshme. Përkundrazi nga teknologjia e prodhimit të betonit do të përftoheshin betone të markave të ndryshme, të cilat do të përdoret për të mirmbajtur argjinaturat, ndertimin e veprave të artit për rruget, urat, ndertesat etj. Të gjitha sa më sipër do të jenë njëkohësisht dhe në zbutjen e efekteve të erozionit lokal.

Mbetjet e ngurta

Mbetjet që do të krijohen nga stafi do të mbledhen në vendet e caktuara nga shoqëria për të terhequr me pas nga pushteti vendor .

Ndikimet mbi popullsinë

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë punësimin e disa baroreve përreth duke kontribuar sadopak në rritjen e mirëqenies në zonë përreth.

Ndikimet në cilësinë e ajrit

Përsa i përket shkarkimeve në ajër nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze të demshme në atmosfere për mjedisin apo banoret e zonës përreth. Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosfere, por vetëm pluhur . Për të minimizuar këto ndikime negative është bërë një izolim në pjesën e daljes së masës së fraksionuar për në transportier, me një skelet dhe dok të gomuar në mënyrë që pluhurat të mos përhapen në mënyrë kaotike, sidomos në kohë të thate dhe me erë.

Ndikimet ne uje

Uji i perdorur ne procesin teknologjik nuk shkarkohet eshte vetem uje per prodhim,persa i perket ujrave te gjeneruar nga stafi ato do te shkarkojne ne sistemin e kanalizimeve te zones.

Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, si dhe nga impianti i prodhimit te betonit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth. Nivelet e zhurmave mund te arrijne nivelin me te larte prej 75dB, por per kohezgjatje relativisht te shkurter.

Ndikimet ne flore dhe ne faune

Humbja dhe demtimi i habitateve, specieve bimore dhe shtazore.

Zona ne sipërfaqen e së cilës është ndërtuar impianti i prodhimit të betonit është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te flores. Perreth kësaj zone, mund te hasim vetem barishte te ndryshme.

Jashtë konturit të impjantit, zona nuk ndryshon. Flora bëhet gjithnjë e më e larmishme duke u larguar nga objekti. Kjo ka të bëjë me bimet e arave dhe pemët të cilat rriten në fushat rreth impjantit. Si zonë kultivon perime si lakrën, bamjen, domaten e shumë perime të tjera. Në pentari mund të përmëndim agrumet, ullinjte, pjeshkat, rrushin, fiqte etj.

Fauna.

Më të pranishem janë zogjtë e llojeve të ndryshme që rriten në zonën e Sarandes, si harabelat, cirlet, mëllenjat, gushkuqi, dallëndyshet etj, insekte e zvarranikë të llojeve të ndryshme. Kafshet e egra ne kete territor jane te kufizuara rrallë mund të takosh gjitarë si nuse lales (Mustela vivalis), lepuri (lepus eurpaeus).

1. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

✚ Emetimet ne ajer

Ne rast te kohes se thate me ere, siperfaqet perreth territorit ku do te zhvillohet aktiviteti, do te sperkaten here pas here me uje me qellim shmangien e emetimit te pluhurave ne ajer. Referuar

natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur. Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë. Ne raste te tilla subjekti perdore sperkatjen me uje here pas here. Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Transporti i materialit inert behet me mjete te pastra sidomos nga balta, gjate transportit mjetet jane te mbuluara ne menyre qe te parandalojne rrjedhjet e materialit ne rruge dhe krijimin e pluhurave.

Shkarkimet e ujerave

Do te kemi vetem shkarkime te ujrave te gjeneruara nga stafi i punojsve te cilat do te shkarkojne ne rrjetin e kanalizimeve te zones. Uji i perdorur ne procesin e prodhimit te betonit me ane te kanalizimeve do te dergohet ne vasken e dekantimit nga ku do te behet ndarja nga sedimentet dhe perseri uji i pastruar kthehet ne proces nga e para.

Rastet aksidentale

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne kantier do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

Plani i menaxhimit

Zbatimi i projektit teknologjik kërkon një menaxhim të saktë të të gjitha halkave kryesore dhe ndihmëse.

Në menaxhimin e këtij projekti ndikojnë shumë faktorë ndër më kryesorët mund të rendisim:

1. Kontrollin e skemes se sistemit te filtrimit te kapjes se pluhurit dhe tymrave.
2. Kontrollin e aparaturave te komandes se procesit te prodhimit.
3. Respektimin e teknologjise se prodhimit te betonit, raportet e lendeve te para qe futen ne proces.
4. Hedhjen e pakontrolluar e mbetjeve te ngurta dhe te lengeta ne ambient.
5. Rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe mbrojtjes nga zjarri

Me qene se kemi te bejme me objekt industrial te prodhimit te betonit, kerkohet nje monitorim i plote i parametrave teknik te projektuar.

Ky investim eshte aktivitet me perfitime ekonomike dhe eshte projektuar dhe ndertuar me teknologji te perparuar qe ndikimet negative ne mjedis te jene minimale.

Impianti do te mbahet nen kontroll gjate gjithë kohes qe eshte ne pune nga personeli inxhinieroteknik.

Zhurmat

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe do punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara nga mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth por as per punonjesit brenda impiantit, sepse eshte brenda normave te lejuara per mjedise pune.

Megjithate aktiviteti ka marre masat perkatese:

- Makinerite duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkates.
- Makinerite qe do te perdoren do te mbyllen here pas here ne kohën kur nuk do te nevojiten per shfrytezim.
- Cdo lloj impianti, sic jane gjeneratorët apo pompat/motoret qe jane te nevojshme per nderhyrje dhe pas oreve te ligjshme te punes do te mbeshtillen me nje pjese akustike apo ekran te levizshem per te minimizuar ndotjen akustike te mjedisit perreth.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si maska kunder pluhurave.
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.

- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

- Ne sheshin e impiantit te betonit do te behet ndarja e materialit ne fraksione te ndryshme dhe keto do te sistemohen ne shesh per tu derguar dhe perdorur neimpinatin e betonit.
- Uji i perdorur ne procesin e prodhimit te betonit me ane te kanalizimeve do te dergohet ne vasken e dekantimit nga ku do te behet ndarja nga sedimentet dhe perseri uji i pastruar kthehet ne proces nga e para.

REKOMANDIME

- Te kontrollohet periodikisht dhe te pastrohet gropa dekantuese. Mbetjet e ngurta qe ndodhen ne masen rreth 5% te perdoren per mbushje te territorit dhe krijimit te mjedisit te pershtatshem per mbjelljen e metejshme te pemeve dhe luleve.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluse ne territor.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.